



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 02, datë 08.11.2019

PËR

MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT TË INFRASTRUKTURËS:
“VAZHDIMI I LUNGOMARES – SEGMENTI JUGOR NGA FUSHAT E SPORTIT DERI
TEK TUNELI”, BASHKIA VLORË”

Në mbështetje të neneve 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 107, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, VKM-së Nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, si dhe VKM-së Nr.519, datë 20.09.2017 “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, me propozim të Bashkisë Vlorë, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin me kusht të Lejes së Ndërtimit të Infrastrukturës: “Vazhdimi i Lungomares – segmenti jugor nga fushat e sportit deri tek tuneli, Bashkia Vlorë”, me zhvillues Bashkinë Vlorë.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave bashkëlidhet si pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Dokumenti i Lejes së Ndërtimit të Infrastrukturës do të lëshohet vetëm pas plotësimit të dokumentacionit tekniko – ligjor.
4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

E. DI RAMA



MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

BELINDA BALLUKU



ANËTAR / SEKRETAR I KKT

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

LEDIA TOTA

